



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më \_\_\_\_\_.2026

**NJOFTIM**

**MBI AFATET DHE PROCEDURAT E KONKURRIMIT TË KANDIDATËVE PËR  
SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL PËR VITIN 2026**

Në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore parauniversitare dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit të punonjësit", më poshtë paraqiten afatet, veprimtaritë dhe institucionet përgjegjëse për procedurën e konkurrimit të kandidatëve për shërbimin psikosocial:

**Afatet dhe Kalendarit i Zhvillimit të Procedurave të Konkurrimit:**

Nr	Veprimtaria	Afati	Përgjegjës
1	Njofitmit për fillimin e procedurave të konkurrimit për SHPS.	18.06.2026	AKAP/DRAP
2	Dërgimi i dosjeve me postë nga kandidatët.	18.06.2026- 26.06.2026	DRAP
3	Vlerësimi i dosjeve dhe shpallja e listës paraprake.	29.06.2026- 30.06.2026	AKAP/DRAP
4	Afati për ankimimet.	01.07.2026- 02.07.2026	DRAP

5	Shqyrtimi i ankimimeve dhe shpallja e listës përfundimtare me pikët e dosjes.	01.07.2026- 02.07.2026	AKAP/DRAP
6	Testimi me shkrim.	06.07.2026	AKAP/DRAP
7	Vlerësimi i testeve dhe shpallja e listës së kandidatëve të kualifikuar me pikët e dosjes dhe testimit.	07.07.2026- 08.07.2026	AKAP/DRAP
8	Afati i ankimimeve për testimin me shkrim dhe shqyrtimi i ankesave.	09.07.2026- 10.07.2026	AKAP/DRAP
9	Intervista e strukturuar.	13.07.2026- 14.07.2026	AKAP/DRAP
10	Shpallja e listës përfundimtare, sipas renditjes për secilin kandidat për pikët e dosjes, testit dhe intervistës së strukturuar.	15.07.2026	AKAP/DRAP

### **Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga kandidatët:**

1. Përshkrimi i edukimit dhe karrierës profesionale - Jetëshkrimi (Curriculum Vitae), sipas Shtojcës 3 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar (e detyrueshme).
2. Kërkesë për aplikim / konkurrim në shërbimin psikosocial (e detyrueshme).
3. Raport mjekoligjor i lëshuar brenda tre muajve të fundit (i detyrueshëm).
4. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/diplomave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të paraqitet edhe akti i njohjes/njësimit nga Ministria e Arsimit (e detyrueshme).
5. Lista e notave e noterizuar për nivelin Bachelor dhe Master (e detyrueshme).
6. Leja për ushtrimin individual të profesionit (licenca) si psikolog ose punonjës social, kopje e njehsuar me origjinalin (e detyrueshme).
7. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga aplikanti, sipas Shtojcës 4 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme).
8. Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, sipas Shtojcës 5 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme).
9. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomave të arsimit shtesë, listave të notave, si dhe certifikatave të gjuhëve të huaja ose kualifikimeve të tjera (nëse ka).
10. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës (nëse ka eksperiencë të mëparshme).

11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale e lëshuar brenda tre muajve të fundit (e detyrueshme).
12. Dëshmi penaliteti (e detyrueshme).

*Duke ju uruar suksese në këtë proces, ju falënderojmë për bashkëpunimin.*

**DREJTOR**

**HAZBI LIKA**